



Human Rights Review Panel

Buletini informativ # 3 – shkurt - prill 2013

- Seanca e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (PShDNj)
- Shkelja e të drejtave të njeriut
- Takimi me shefin e misionit të EULEX-it në Kosovë
- Anëtarja e re zëvendësuese e PShDNj-së
- Fushata informuese

Seanca e PShDNj-së

PShDNj-ja ka mbajtur seancën e 15-të të rregullt nga data 8 deri më 10 prill 2013 në Prishtinë, ku i ka shqyrtuar 11 prej 21 ankesave në pritje.

Shkelja e të drejtave të njeriut

Paneli ka vendosur njëzëri se EULEX-i në Kosovë ka shkelur nenin 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, pra të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, në lëndën nr. 2011-07, [W kundër EULEX-it](#). Parashtruesi i ankesës ka pretenduar se prokurorët e EULEX-it e kanë dërguar deklaratën e dëshmisë së tij dhe informatat e tjera personale tek autoritetet shtetërore në Serbi në një gjykim për krime lufte. PShDNj-ja ka konstatuar se për të zbuluar deklaratën dhe të dhënat personale të parashtruesit të anekses ka ekzistuar arsyetim i pamjaftueshëm, për shkak të mungesës së një baze ligjore, për shkak të mungesës së pëlqimit të tij dhe për shkak të mungesës së kryerjes së vlerësimit të rrezikut për t'i përcaktuar masat mbrojtëse, të nevojshme për t'i kufizuar rreziqet që përshiheshin. PShDNj-ja gjithashtu ka rekomanduar të merren një sërë masash korigjuese nga shefi i misionit, për t'ju qasur këtyre çështjeve në fjalë.

Vendimet

PShDNj-ja ka gjetur [katër ankesa](#) të pranueshme në lidhje me shkeljet e dyshuara të të drejtave të njeriut në ditën e *Vidovdanit*, më 28 qershor 2012. Gjithashtu PShDNj-ja ka shpallur katër lëndë të tjera si të papranueshme dhe ka vendosur t'i dërgoj katër lëndë të tjera tek shefi i misionit për njoftim dhe vërejtje nga ai.

Nëse mendoni që jeni viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it në Kosovë, ju mund të parashtroni ankesë pranë Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Ankesa duhet të parashtrohet brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar, dhe duhet që jetë me shkrim.

Për më shumë informata vizitoni www.hrrp.eu

Takimi me shefin e misionit të EULEX-it

Bernd Borchardt, shef i misionit të EULEX-it në Kosovë, i shoqëruar nga Joëlle Vachter, zëvendëse e shefit të misionit, janë takuar me PShDNj-në më 9 prill 2013. Ky takim ka qenë me një karakter njoftues dhe i ka mundësuar Panelin që ta njoftoj z. Borchardt dhe znj. Vacher rreth mandatit, procedurave dhe punës së vet, si dhe për të diskutuar rreth çështjeve me interes dhe shqetësim të përbashkët.



Pjesëmarrësit në këtë takim: Miguel Carvalho, Joëlle Vachter, Bernd Bochartd, shef i misionit të EULEX-it, John J Ryan, Roberto Donatantonio, Katja Dominik, Guenael Mettraux, Magda Mierzevska, Elka Filcheva-Ermenkova, Joanna Marszalik dhe Florian Razesberger.

Po ashtu PShDNj-ja ka mbajtur takime të ngjashme të karakterit njoftues me Charles Smith III, kryetar i asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, Jaroslava Novotna, kryeprokurore e EULEX-it, Jonathan Ratel, shef i zyrës së prokurorisë speciale dhe me ambasadorin Jean-Claude Schlumberger, shef i misionit të OSBE-së në Kosovë.

Anëtarja e re zëvendësuese e PShDNj-së

Znj. Elka Filcheva-Ermenkova, shtetase e Bullgarisë, ka studiuar për juridik në Universitetin e Blagoevgrad-it, Bullgari, prej nga u diplomua në vitin 1997. Nga viti 1998 deri 2008 ajo ka punuar si gjykatëse e shkallës së parë dhe gjykatëse e Apelit në Bullgari, ndërsa ajo ka specializuar në çështjet e ligjit civil dhe penal.

Ajo ishte dërguar si këshilltare për sundimin e ligjit në Departamentin e Planifikimit Civil Dhe Mundësive Operacione, në Këshillin e Bashkimit Evropian në janar të vitit 2008, ku ajo ka punuar deri në janar të vitit 2012.

Znj. Filcheva-Ermenkova ishte punësuar nga EULEX-i në Kosovë në janar të vitit 2012, ku më pas ajo u emërua gjykatëse e Apelit për Komisionin për ankesa pronësore. Shefi i misionit ka emëruar znj. Filcheva-Ermenkova anëtare zëvendësuese të PShDNj-së në janar të vitit 2013.



Paneli ka përpunuar një tabelë të hollësishme të jurisprudencës, ku përmbledhen shumë çështje që lidhen me juridiksionin e vet, çështje procedurale si dhe me meritat e rasteve. Tabelën mund ta shihni përmes faqes së internetit të Panelin në www.hrrp.eu/jurisprudence.php

Fushata informuese

PShDNj-ja mbetet e shqetësuar se pavarësisht nga përpjekjet e saj maksimale në zbatimin e fushatës informuese, ende ekziston një mungesë serioze e njohjes së rolit të tij si mekanizëm llogaridhënës për shkeljet e dyshuara të të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv.

Prandaj, PShDNj-ja ka zhvilluar një plan të veprimit për zgjerimin e fushatës informuese për vitin 2013. Deri më tani ka mbajtur takime në Ferizaj, Pejë, Prizren dhe Mitrovicë të veriut, ku ka takuar dhe njoftuar partnerët për zbatim, siç janë OJQ-të për të drejta të njeriut, zyrtarë publik/institucional, përfaqësues fetar dhe organizata ndërkombëtare, siç është OSBE-ja. Sekretariati është takuar në Beograd me personelin e OJQ-së që kanë projektin e financuar nga BE-ja: *“Mbështetje për zbatimin e strategjive për persona të zhvendosur brenda vendit, refugjatë dhe të kthyer që gjenden në Serbi”* (Europaid/129209/C/SER/RS/), ku i ka njoftuar ata rreth mandatit, procedurave dhe punës së tij.

Sekretariati po ashtu ka vazhduar fushatën informuese në Prishtinë, ku ndër të tjera është takuar me myftiun z. Naim Tërnavën, kryetar i Bashkësisë Islame të Kosovës dhe me z. Sami Kurteshin, avokat i popullit i Kosovës.



Pjesëmarrësit e takimit midis Sekretariatit të PShDNj-së dhe avokatit të popullit të Kosovës, nga e majta në të djathtë: Isa Hasani, Joanna Marszalik, John J Ryan, Kushtrim Xhaferi dhe Sami Kurteshi, avokat i popullit i Kosovës.

Statistikat e lëndëve - prill 2013



Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut - Sekretariati

Rruga: Rrustem Statovci nr. 29 – 10000 Prishtinë – Kosovë

Tel: +386 (0) 43 78 2125 - Fax: +381 (0) 38 78 7711

Për t'u abonuar në buletin informativ shkruani në: office@hrrp.eu

www.hrrp.eu